



Tendencat për politizim të KPMSHCK



**(Analizë e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin
e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të
Shërbimit Civil në Kosovë)**

Prishtinë, tetor 2022

Autor: Gzim Shala

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Tetor, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Roli i KPMSHCK.....	5
3. Ndërhyrja kundërkushtetuese në kompetencat e KPMSHCK.....	6
4. Heqja e imunitetit të anëtarëve të KPMSHCK.....	7
5. Absurdi i shtyrjes së ekzekutimit të vendimit të KPMSHCK.....	9
6. Mungesa e shpjegimeve për miratimin e këtij ligji	10
7. Kuvendi të respektojë kushtetutën.....	11

1. Përmbledhje ekzekutive

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Tutje: KPMSHCK) është institucion kushtetues i cili siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Më 30 shtator 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte miratuar Projektligjin Nr.08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Tutje: Projektligji). Aktualisht, ky Projektligj është duke u shqyrtuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në kundërshtim me Kushtetutën, Projektligji synon ta ngushtojë funksionin e KPMSHCK, duke i kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë që i garanton Kushtetuta në kuptim të respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës. Një qasje e tillë cenon rëndë autoritetin e këtij mekanizmi kushtetues, dhe i hap rrugë politizimit të sektorit publik në Kosovë, pasigurisë juridike dhe arbitraritetit ndaj zyrtarëve publik. Fatkeqësisht, po kjo iniciativë legjislative është iniciuar nga Zyra e Kryeministrit.

Sipas Projektligjit, KPMSHCK nuk do të ketë kompetencë të vendosë për ankesat kundër vendimit të Qeverisë për nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese. Kundër këtyre vendimeve, pala ka të drejtë të hap konflikt administrativ në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin përkatës për konfliktet administrative. Kjo dispozitë, është në kundërshtim me disa nene të Kushtetutës. Krahas shkeljes kushtetuese, reflektimi i kësaj dispozite në praktikë paraqet një potencial shumë të lartë për cënim të të drejtave të njeriut, influencë politike në rekrutimin e këtyre pozitave dhe dëmtim të buxhetit.

Projektligji synon që t'ua marr imunitetin funksional Kryetarit dhe anëtarëve të KPMSHCK. Marrja e imunitetit për kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK drejt për së drejti cenon pavarësinë e këtij institucioni si dhe cënon të drejtat e palëve. Është absurde të konsiderohet se për secilin rast, anëtarët e KPMSHCK do të bartin edhe përgjegjësi civile. Kjo pasiguri juridike do të ndikojë në hezitimin e profesionistëve për tu bërë pjesë e KPMSHCK si dhe do të krijojë potencial të madh për politizimin e këtij komisioni nga ana e partive politike që kanë mazhorancën në Kuvend.

Sipas Projektligjit, në secilin rast kur ndaj vendimit të KPMSHCK iniciohet padi në gjykatë, vendimi i KPMSHCK nuk do të zbatohet deri në momentin kur gjykata të nxjerrë vendim të formës së prerë. Kur kësaj, i shtohet fakti, se procedurat gjyqësore në lëndët administrative marrin mbi tre vite kohë për tu trajtuar, e kthen KPMSHCK në një institucion të pa vlerë dhe pa asnjë ndikim, duke marr kompetencat kushtetuese të këtij institucioni. Për këtë, IKD gjen se përdërisa vendimet e KPMSHCK (në rastet kur iniciohet padi) nuk janë të zbatueshme, procedura pranë KPMSHCK praktikisht paraqet vetëm zvarritje procedurale pa asnjë peshë relevante. Kështu, praktikisht, Projektligji e përjashton tërësisht relevancën e KPMSHCK në shërbimin civil. Kjo zgjidhje ligjore është në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Përtej dëmtimit të interesave të qytetarëve, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore administrative në praktikë cenon në thelb funksionimin normal të shërbimit civil.

Projektligji në tërësinë e tij është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky Projektligj e bënë tërësisht irelevant rolin e një institucioni kuazi gjyqësor i cili kujdeset për mbrojtjen e standardeve në fushën e shërbimit civil. Me këtë projektligj, një armatë e tërë e dhjetëra mijëra shërbyesve civil mbesin pa mbrojtje efektive juridike të cilëve u pakësohen të drejtat e tyre Kushtetuese.

Në këtë Projektligj, nuk ka asnjë dispozitë të vetme e cila nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Thënë ndryshe, në këtë Projektligj nuk ka asnjë dispozitë që ia vlen të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Për këto arsye, me qëllim të mbrojtjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mbrojtjes së institucionit kryesor që mbron rregullat e shërbimit civil, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta refuzojë këtë ligj.

2. Roli i KPMSHCK

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është institucion i cili kujdeset për respektimin e rregullave në fushën e shërbimit civil. KPMSHCK është institucion kushtetues. Dispozita e nenit 101 të Kushtetutës, është dispozitë e cila flet për shërbimin civil. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton parimet kryesore kushtetuese mbi të cilat duhet të ndërtohet shërbimi civil derisa paragrafi i dytë përcakton obligimin për themelimin e një këshilli që sigurohet për respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Neni 101.2. i Kushtetutës ka përcaktuar se “Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës”.

KPMSHCK funksionon përmes Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Fushëveprimi i këtij ligji [neni 2] përfshinë Këshillin dhe të gjitha institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil. Ky ligj kishte qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila përmes aktgjyimit kishte shfuqizuar disa prej dispozitave të këtij ligji¹.

Më 30 shtator 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte miratuar Projektligjin Nr.08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në fazën e konsultimit publik, ky projektligj përmbante vetëm katër nene, derisa i njëjti projektligj në Qeveri është miratuar me nëntë nene. Aktualisht, ky Projektligj është duke u shqyrtuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Më 17 tetor 2022, ky projektligj është miratuar në parim nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal. Ky projektligj, është objekt i kësaj analize.

¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KO171/18, 20 maj 2019.

3. Ndërhyrja kundërkushtetuese në kompetencat e KPMSHCK

Ligji për KPMSHCK ka përcaktuar funksionet e këshillit, ku përcaktohet se [Neni 6.1.1.14.] ky këshill shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil. Projektligji, synon ta ngushtojë këtë funksion të KPMSHCK. Sipas Projektligjit, KPMSHCK nuk do të ketë kompetencë të vendosë për ankesat kundër vendimit të Qeverisë për nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese. Kundër këtyre vendimeve, pala ka të drejtë të hap konflikt administrativ në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin përkatës për konfliktet administrative. Kjo dispozitë, është në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e nenit 101 të Kushtetutës, duke kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit me ligj, përderisa të njëjtat janë të garantuara me Kushtetutë.

Neni 101 i Kushtetutës flet për një sistem unik të shërbimit civil dhe një Këshill të vetëm që kujdeset për këtë shërbim. Ky nen, nuk lejon shmangie ligjore të këshillit nga ky rol. Kështu, përderisa KPMSHCK është institucion kushtetues dhe si i tillë kujdeset për gjithë shërbimin civil, pakësimi i kompetencave të këtij Këshilli me ligj është në kundërshtim të drejt për drejt me Kushtetutën.

Nën kuptimin e nenin 32 të Kushtetutës, përcaktimi i KPMSHCK si institucion kushtetues për të mbrojtur rregullat mbi shërbimin civil ka për qëllim, krahas mbrojtjes së meritokracisë në shërbimin civil, edhe garantimin e mjeteve juridike efektive për subjektet të cilët janë pjesë e procedurave ku zbatohen rregullat e shërbimit civil. Kështu, kjo dispozitë e projektligjit nuk shihet vetëm si pakësim i kompetencave kushtetuese të KPMSHCK në drejtim të një pjese të shërbimit civil por edhe si mohim i një pjese të shërbimit civil në të drejtat e tyre kushtetuese, përkatësisht në të drejtën e tyre për përdorimin e mjeteve juridike administrative. Kështu, kjo dispozitë e Projektligjit pakëson të drejtat e njeriut [neni 32] të garantuara me Kushtetutë. E drejta e qytetarëve për të iniciuar procedurë gjyqësore nuk e sanon këtë shkelje, pasi neni 32 i Kushtetutës garanton të drejtën si për aplikim të mjeteve juridike administrative ashtu edhe të atyre gjyqësore.

Projektligji përjashton nga e drejta e ankesës në KPMSHCK një pjesë të zyrtarëve publik derisa u lejon mundësinë për ankesë zyrtarëve të tjerë publik. Kjo qasje selektive, është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës, që garanton barazinë para ligjit. Në një situatë analoge, kështu kishte vlerësuar edhe Gjykata Kushtetuese, ku kishte theksuar se *“trajtimi i pabarabartë i shërbyesve civil në raport me kompetencën e Këshillit për mbikëqyrje të përzgjedhjes së shërbyesve civil, i përcaktuar me nenin 6, paragrafi 1.2, i Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës”*².

Krahas shkeljes kushtetuese, reflektimi i kësaj dispozite në praktikë paraqet një potencial ekstremisht të lartë për cënim të të drejtave të njeriut, influencë politike në rekrutimin e këtyre pozitave dhe dëmtim të buxhetit. Sipas të dhënave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Tutje: KGJK), kohëzgjatja për trajtimin e një lënde administrative nga dita e ngritjes së padisë e deri

² Po aty, par.186.

në momentin e plotfuqishmërisë së vendimit është 3.2 vite³. Kështu, përderisa një person ka pasur mundësi që ta realizojë të drejtën e tij në rrugë administrative, pranë KPMSHCK, ai duhet që të presë 3.2 vite që për rastin e tij të merret një vendim gjyqësor. Nën këtë situatë, edhe llogaridhënia e institucioneve që përzgjedhin këta zyrtarë është shumë e ulët, pasi fatura vie shumë më vonë. Nën këtë situatë, potenciali për ndikim politik është shumë i lartë. Ndërsa, nëse pas një kohe kaq të gjatë vendimi gjyqësor i jep të drejtë ankuesit, krahas shkeljes së të drejtës së ankuesit për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, dëm i konsiderueshëm do t'i shkaktohet edhe buxhetit të shtetit, ku ankuesi tanimë do të kompensohet për gjithë periudhën kohore deri në momentin kur është nxjerrë vendimi gjyqësor.

Kështu, kjo dispozitë e cila qartazi është në kundërshtim me Kushtetutën dhe krijon dëme të pariparueshme në shërbimin civil, duhet të fshihet nga Projektligji.

4. Heqja e imunitetit të anëtarëve të KPMSHCK

Neni 11.3. i Ligjit për KPMSHCK ka përcaktuar se “*Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi*”. Me Projektligj, ky nen synohet të fshihet. Pra, sipas Projektligjit, kryetari dhe anëtarët e KPMSHCK nuk do të kenë imunitet lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve të tyre.

Fillimisht, duhet theksuar faktin se po ky nen ka qenë objekt i trajtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Kjo Gjykatë kishte konsideruar se i njëjti nen nuk është në kundërshtim me Kushtetutën⁴.

Sa i përket imunitetit i cili garantohet në nenin 11.3 të Ligjit, i cili nen synohet të fshihet përmes projektligjit, duhet ta kemi parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me imunitet funksional, i cili është i kufizuar vetëm në ushtrimin e funksioneve zyrtare nga një person i caktuar. Përkatësisht, përmes këtij lloji imuniteti, kryetari dhe anëtarëve e KPMSHCK mbrohen vetëm sa i përket veprimeve të tyre të ndërmarra gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Këto veprime manifestohen në pikëpamjet që ata shprehin, mënyrën se si votojnë dhe vendimet që nxjerrin. Zyrtarët të cilëve u garantohet ky lloj imuniteti, i cili vazhdon edhe pasi zyrtari ta përfundojë detyrën e tij, nuk janë të detyruar t'i përgjigjen askujt për veprimet e tyre të ndërmarra gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar. Të gjitha veprimet e tjera të cilat tejkalojnë fushëveprimin e tyre, i cili fushëveprim manifestohet me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit dhe vendimet e nxjerra, nuk mbulohet nga ky lloj imuniteti⁵.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të rolit që ka, KPMSHCK gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁶, përkundër faktit

³ **Shënim:** Kalkulimi është bërë mbi bazën e të dhënave të KGJK-së dhe formulës sipas të cilës KGJK kalkulon kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore.

⁴ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KO171/18, 20 maj 2019, paragrafi 253.

⁵ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KO98/11, 20 shtator 2011, paragrafi 54.

⁶ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KI33/16, 04 gusht 2017, paragrafi 54.

se kjo gjykatë ka përcaktuar se imuniteti i kryetarit dhe anëtarëve të këtij këshilli nuk është imuniteti që ju takon gjyqtarëve sipas kushtetutës⁷.

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, imuniteti funksional është i rëndësishëm si për pavarësinë e gjyqtarëve ashtu edhe për të drejtat e palëve. Në rastin e parë, imuniteti funksional u mundëson gjyqtarëve që të kryejnë detyrat e tyre pa frikën se ushtrimi i kompetencave të tyre mund të rezultojë që ata të konsiderohen përgjegjës për dëmet e shkaktuara. Po ashtu, ky lloj imuniteti u mundëson gjyqtarëve që të fokusohen në punën e tyre dhe që të mos shqetësohen vazhdimisht nga paditë e ngritura ndaj tyre. Krahas kësaj, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, imuniteti funksional u mundëson palëve që të apelojnë vendimet gjyqësore në shkallë më të lartë dhe që mos kenë nevojë që të hapin një rast të veçantë civil. Pra, nën këtë frymë, kuptohet fakti se qytetarët do t'i atakojnë vendimet e nxjerra dhe jo vendimmarrësit⁸.

Me rastin e vlerësimit të këtij neni, Gjykata Kushtetuese kishte potencuar se “ajo që është e rëndësishme është nëse palët kanë të drejtë, të përdorin mjete juridike, ndaj vendimeve të Këshillit pa pasur nevojë që të ngrisin përgjegjësinë personale”⁹. Po ashtu, sipas kësaj gjykate, “duke pasur parasysh imunitetin e limituar që u garantohet anëtarëve të Këshillit përmes nenit 11, paragrafi 3 të Ligjit të kontestuar, si dhe faktin që ndaj vendimeve të Këshillit palët kanë të drejtë të hapin konflikt administrativ, Gjykata vlerëson se masa e përdorur është proporcionale me qëllimin që dëshirohet të arrihet pasi palët e interesuara kanë mundësi të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre ndaj vendimeve të Këshillit duke hapur konflikt administrativ”¹⁰. Mbi këto dhe arsye të tjera, Gjykata Kushtetuese kishte konkluduar se ky nen është në përputhje me Kushtetutën.

Në anën tjetër, sipas Ligjit për KPMSHCK [neni 15], anëtarët e KPMSHCK shkarkohen nga Kuvendi me shumicë votash. Në mungesë të imunitetit funksional, që anëtarët e këtij këshilli i mbron nga, ndër të tjera, shkarkimi, i bie se bazë për shkarkim mund të konsiderohen edhe rastet e veçanta. Nisur nga fakti se për shkarkimin e anëtarëve të KPMSHCK kërkohet vetëm shumicë e thjeshtë, kjo bazë krijon potencial të lartë për kapje të këtij institucioni nga qeveria e cila ka mazhorancën në Kuvend.

Për këto arsye, marrja e imunitetit për kryetarin dhe anëtarët e KPMSHCK drejt për së drejti cënon pavarësinë e këtij institucioni si dhe cënon të drejtat e palëve. Është absurde të konsiderohet se për secilin rast, anëtarët e KPMSHCK do të bartin edhe përgjegjësi civile. Kjo pasiguri juridike do të ndikojë në hezimin e profesionistëve për tu bërë pjesë e KPMSHCK si dhe do të krijojë potencial të madh për politizimin e këtij komisioni nga ana e qeverisë e cila e ka mazhorancën në Kuvend.

Mbi këto arsye dhe nisur nga mungesa e arsyetimeve mbi nevojën e heqjes së këtij neni nga Ligji, krijohet perceptimi i një tendence negative, për politizim të qëllimshëm të këtij

⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KO171/18, 20 maj 2019, paragrafi 227.

⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rasti Gryaznov kundër Rusisë, 12 qershor 2012, paragrafi 78.

⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KO171/18, 20 maj 2019, paragrafi 249.

¹⁰ Po aty, paragrafi 252.

institucioni. Ky perceptim cenon në thelb besimin e publikut në këtë institucion dhe si rrjedhojë cenon edhe sistemin e shërbimit civil në tërësi.

5. Absurdi i shtyrjes së ekzekutimit të vendimit të KPMSHCK

Në procedurë administrative, KPMSHCK vepron si shkallë e dytë. Në secilin rast kur merret një vendim nga ana e institucionit në procedurë administrative të shkallës së parë, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në KPMSHCK. Sipas Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative [neni 130], parashtrimi i ankesës e pezullon zbatimin e vendimit të shkallës së parë. Sipas Ligjit, vendimi i KPMSHCK konsiderohet i formës së prerë dhe është vendim i zbatueshëm. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të KPMSHCK, përjashtimisht nëse gjykata vlerëson se në një rast specifik kjo duhet të ndodhë dhe vendos masë të përkohshme¹¹.

Sipas Projektligjit, në secilin rast kur ndaj vendimit të KPMSHCK iniciohet padi në gjykatë, vendimi i KPMSHCK nuk do të zbatohet deri në momentin kur gjykata të nxjerrë vendim të formës së prerë. Në këtë drejtim, Projektligji [neni 7] ka përcaktuar se “Në rastet kur iniciohet konflikt administrativ ndaj vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente, ekzekutimi i vendimit për rastin bëhet vetëm kur ka vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente”.

Kjo zgjidhje ligjore është në kundërshtim me dallimet konceptuale në mes të procedurës administrative dhe procedurës gjyqësore. Këto dy procedura, janë procedura të ndryshme dhe të ndara. Procedura administrative, e cila përfundon në shkallë të dytë brenda institucioneve administrative, rregullohet me ligj tjetër nga konflikti administrativ që zhvillohet në gjykatë. Për këtë arsye, ndërlidhja e zbatueshmërisë së vendimit të KPMSHCK me vendimin e gjykatës, përderisa gjykata nuk ka shqiptuar masë të përkohshme, është përzierje e dallimeve bazë në mes të procedurës administrative dhe asaj gjyqësore.

Ekzistimi i KPMSHCK si organ administrativ për mbrojtjen e të drejtave gjyqësore ka për synim zgjidhjen e problemeve brenda administratës si dhe ngritjen e efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve. Pezullimi ex lege i vendimit të KPMSHCK deri në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë praktikisht paraqet përjashtim të KPMSHCK nga roli i saj kushtetues dhe pamundëson zgjidhjen e ankesave brenda procedurës administrative. Kjo pasi në rastet kur iniciohet konflikt administrativ, relevanca do të jetë vetëm tek vendimi gjyqësor dhe jo tek vendimi i këshillit. Kjo pasi vendimi i këshillit, nuk do të mund të implementohet asnjëherë, derisa të ketë vendim gjyqësor.

Inicimi i konfliktit administrativ do të mundësohej edhe nëse KPMSHCK nuk do të ekzistonte fare. Kështu, nën këtë situatë, përderisa vendimet e KPMSHCK (në rastet kur iniciohet padi) nuk janë të zbatueshme, procedura pranë KPMSHCK praktikisht paraqet vetëm zvarritje procedurale pa asnjë peshë relevante.

¹¹ Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, neni 22.

Kjo zgjidhje ligjore është në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Vendimet e KPMSHCK nga Gjykata Kushtetuese janë cilësuar si vendime “përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme”¹². Kështu, Projektligji në këtë pjesë bie ndesh me praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Duhet theksuar faktin se sipas Ligjit 05/L-031 për Konfliktet Administrative, nëse rrethanat e rastit kërkojnë shtyrjen e ekzekutimit të një vendimi të KPMSHCK, atëherë gjykata mund të caktojë masën e përkohshme¹³. Nën rregullimin sipas dispozitave të Projektligjit, masa e përkohshme tanimë nuk ka kuptim.

Sipas kësaj zgjidhje absurde të projektligjit, secili person që paraqet ankesë duhet që fillimisht të shtjerrë procedurën tanimë jo relevante pranë KPMSHCK e më pastaj duhet të presë vendimin gjyqësor. Sipas të dhënave të KGJK-së, kohëzgjatja e trajtimit të një rasti gjyqësor administrativ nga momenti i inicimit të padisë e deri në vendimin e formës së prerë është 3.2 vite. Kjo i bie se përderisa lëndët në KPMSHCK do të trajtoheshin brenda një afati optimal, secili qytetar duhet të presë 3.2 vite që lënda e tij të marrë epilog. Pra, në këtë situatë, tanimë praktikisht nuk ekzistojnë fare mjetet juridike administrative derisa mjetet juridike gjyqësore nuk janë efektive.

Përtej dëmtimit të interesave të qytetarëve, kjo kohëzgjatje cënon në thelb funksionimin normal të shërbimit civil. Në shërbimin civil, ka vazhdimisht procedura të ndryshme, si procedurat e rekrutimit, avancimit etj. Në të gjitha këto raste, kur një institucion merr një vendim, me rastin e parashtrimit të ankesës në KPMSHCK, ai vendim pezullohet¹⁴. Ky pezullim, nuk përfundon as pas nxjerrjes së vendimit të KPMSHCK, por duhet pritur edhe vendimi gjyqësor i formës së prerë. Pra, për të përfunduar një procedurë në kuadër të shërbimit civil, institucionet duhet të presin 3.2 vite. Kjo në secilin rast kur paraqitet padi. Kjo pritje, paraqet bllokim total të sistemit të shërbimit civil dhe pamundësi objektive për çfarëdo lloj planifikimi strategjik të institucioneve, pasi sistemi për menaxhimin e resurseve njerëzore, shërbimi civil, tanimë është i bllokuar.

6. Mungesa e shpjegimeve për miratimin e këtij ligji

Projektligji është hartuar nga Zyra e Kryeministrit¹⁵. Në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës, krahas projektligjit, janë publikuar edhe dokumentet e tjera përcjellëse të Projektligjit, si

¹² Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KO127/21, 21 dhjetor 2021, paragrafi 102.

¹³ Ligji 05/L-031 për Konfliktet Administrative, neni 22.

¹⁴ Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 130.

¹⁵ “Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës”. Platforma e konsultimeve publike, Zyra për Qeverisje të mirë, (Shih linkun: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41464>. (Qasur për herë të fundit më 26 tetor 2022).

memorandumi shpjegues, deklarata për vlerësimin e ndikimit financiar, deklarata për përafrimin dhe harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe opinioni ligjor¹⁶.

Këto dokumente, më shumë duket se i janë bashkangjitur Projektligjit si formalitet se sa si dokumente përmes të cilave mund të sqarohet Projektligji dhe qëllimi i hartuesve të këtij Projektligji. Memorandumi shpjegues i këtij Projektligji kaq të rëndësishëm, i përkthyer në tri gjuhë, është më pak se 3 faqe¹⁷. Në materien e këtij memorandumi, përsëriten fjali të përgjithshme dhe veprime procedurale, por se nuk tregohet arsyeja e miratimit të këtij Projektligji. Në këtë memorandum thuhet se “Ky Projektligj synon eliminimin e disa mangësive ligjore në mënyrë që KPMSHCK t'i ushtroj kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi” por se nuk sqarohet se cilat janë këto mangësi. Kështu, ndonëse këtij Projektligji i është bashkangjitur memorandumi shpjegues, ky memorandum realisht nuk shpjegon asgjë mbi këtë Projektligj.

7. Kuvendi të respektojë kushtetutën

Siç u elaborua më lartë, Projektligji në tërësinë e tij është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky Projektligj e bënë tërësisht irrelevant rolin e një institucioni kuazi gjyqësor i cili kujdeset për mbrojtjen e standardeve në fushën e shërbimit civil. Në këtë Projektligj, nuk ka asnjë dispozitë të vetme e cila nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Thënë ndryshe, në këtë Projektligj nuk ka asnjë dispozitë që ia vlen të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Për këto arsye, me qëllim të mbrojtjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mbrojtjes së institucionit kryesor që mbron rregullat e shërbimit civil, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta refuzojë këtë ligj. Për shkak të, siç u arsyetua më lartë, mungesës së një dispozite të vetme pozitive në këtë Projektligj, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta refuzojë në parim këtë Projektligj, përkundër faktit se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal e ka bërë të kundërtën. Për më tepër, do të ishte shumë e rrugës që vet Qeveria e Republikës së Kosovës ta tërheqte këtë nga Kuvendi.

Nëse nuk ndodh kjo, bazuar në dispozitat Kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ky ligj nuk ka gjasa që të kalojë filtrin e Gjykatës Kushtetuese. Nisur nga praktika e Gjykatës Kushtetuese në raport me KPMSHCK, çdo kontestim i këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese, do të sjellte shfuqizim të të njëjtit, për shkak të shkeljes së dispozitave kushtetuese.

¹⁶ “Projektligji nr.08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kuvendi i Kosovës”. (Shih linkun: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=419>). (Qasur për herë të fundit më 26 tetor 2022).

¹⁷ “Memorandumi Shpjegues i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit NR. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës”. Qeveria e Kosovës. (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/memorandumishpjegues_SuwjnkFBYr.pdf). (Qasur për herë të fundit më 26 tetor 2022).

Krejt në fund, nëse Qeveria dhe Kuvendi nuk reflektojnë dhe miratojnë Projektligjin, u takon të gjitha palëve të autorizuara në kuptim të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që të angazhohen që këtë Projektligj ta përcjellin për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese. Nëse kjo nuk ndodh, KPMSHCK si organ kushtetues më praktikisht nuk do ketë asnjë rol dhe kjo domosdoshmërisht do të reflektohet si në cenimin e të drejtave të palëve por veçanërisht në cenimin e meritokracisë së shërbimit civil në Kosovë.